



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë 21.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 18.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "DT Group SHPK&Inova SHPK" për aktivitetin: "Ndertimi i Qendres të Mjekesise Familjare në Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511 nxjerr:

V E N D I M

Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "DT Group SHPK&Inova SHPK" e datës 18.09.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i Qendres të Mjekesise Familjare në Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511.

Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj tutje me *kete aktivitet*.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "DT Group SHPK&Inova SHPK" me datë 18.09.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i Qendres të Mjekesise Familjare në Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511.

Autoriteti Kontraktues, me datë 21.09.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e OE-ik "DT Group&Inova SHPK lidhur me aktivitetin e prokurimit: Ndertimi i Qendres të Mjekesise Familjare në Veternik" dhe me numër të prokurimit: 616 -20-1234-511.

-Pretendimi se ky grup i OE-ik ka plotësuar kërkesat për stafin është i pa qëndrueshëm, pasi që nuk ka dorëzuar dëshmi të kompletuara sipas kërkesës nga FDT-dhe për të njëjtën i është


dhene sqarimi ne letrën per refuzimin e tenderit.por per korrektësi ua rikujtojmë se me nenin 38.9.te Rregullave dhe Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik eshte përcaktuar qarte se nëse CV-ja nuk përmbush kërkesat-refuzo tenderin pa kërkuar informacion te mëtejshëm.Pra eshte e qarte se kërkesa juaj ne kete pike nuk ka qene e kompletuar per mungese te referencave nga punëdhënësi.

-Lidhur me pretendimin tjetër qe lidhet me referencat nga OE-ik “Noti Beton”ju sarojme se këto referenca kenë te bëjnë me Autoritetin tone Kontraktues dhe kam kërkuar sqarime nga njerëzit me kompetent per kete-Menaxheret e projekteve,te cilët deklarojnë se ne realizimin e ketyre projekteve nuk ka pase asnjë nenkontraktor duke perfshire eshë kompanitë tuaja nga grupi i OE-ik,te paraqitura ne kete aktivitet.Lidhur me kete ua përkujtoj se ne Njoftimin per refuzim te tenderit tuaj eshte përdorur nje termin mjaft i bute dhe jo adekuat duke e trajtuar si reference te pa bazuar,e qe realisht eshte dëshmi e rrejshme dhe per kete bazuar ne detyrimet ligjore do te kërkohet ndërmarrja e masave nga Organi Kompetent-Organi Shqyrtues i Prokurimit ndaj jush dhe ndaj OE-ik qe ka lëshuar këto referenca.

Bazuar ne sqarimet paraprake u vendos si ne Dispozitiv te Vendimit.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit